



**Republika e Kosovës**

Republika Kosova

Republic of Kosovo



**Autoriteti i Avacionit Civil i Kosovës**

Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova

Civil Aviation Authority of Kosovo

---

**RREGULLORE (AAC) NR. 07/2022 PËR PLOTËSIMIN E RREGULLORES (AAC) NR. 09/2017 PËR RAPORTIMIN,  
ANALİZËN DHE PËRCJELLJEN E NDODHIVE NË AVIACIONIN CIVIL, NË LIDHJE ME SKEMËN E PËRBASHKËT  
EVROPIANE TË KLASIFIKIMIT TË RREZIKUT**

**REGULATION (CAA) NO. 07/2022 SUPPLEMENTING REGULATION (CAA) NO 09/2017 ON THE REPORTING,  
ANALYSIS AND FOLLOW-UP OF OCCURRENCES IN CIVIL AVIATION, AS REGARDS THE COMMON EUROPEAN  
RISK CLASSIFICATION SCHEME**

**UREDJA (ACV) BR. 07/2022 KOJIM SE DOPUNJAVA UREDJA (ACV) BR. 09/2017 O IZVEŠTAVANJU, ANALIZI I  
PRAĆENJU DOGAĐAJA U CIVILNOM VAZDUHOPLOVSTVU, U VEZI SA ZAJEDNIČKOM EVROPSKOM ŠEMOM  
KLASIFIKACIJE RIZIKA**

<p>Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të neneve 3.5, 15.1 pika (c), (e), dhe (j), 21.2 21.3 99.3 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr. 28, datë 4 qershor 2008), i ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 2022/30, dt. 5 shtator 2022),</p> <p>Duke marr parasysh,</p> <p>Detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në lidhje me Marrëveshjen Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (më tutje referuar si "Marrëveshja për HPEA") që prej hyrjes së saj të përkohshme në Kosovë më 10 tetor 2006,</p> <p>Regulloren (AAC) Nr. 05/2020 të datës 30 tetor 2020, e cila zbaton në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 2018/1139 të datës 4 korrik 2018, që përcakton rrregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe</p>	<p>Director General of Civil Aviation Authority of the Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to Articles 3.5, 15.1 item (c), (e), and (j), 21.2 21.3 and 99.3 of the Law No. 03/L-051 on Civil Aviation ("Official Gazette of the Republic of Kosovo", Year III, No. 28, of 4 June 2008), as amended with Law no. 08/L-063 on amending and supplementing the laws related to the rationalization and establishment of accountability lines of the Independent Agencies ("Official Gazette of the Republic of Kosovo", No. 2022/30, of 5th September 2022),</p> <p>Taking into consideration,</p> <p>International obligations of the Republic of Kosovo towards Multilateral Agreement on Establishing the European Common Aviation Area (hereinafter "ECAA Agreement") since its provisional entry into force for Kosovo on 10 October 2006,</p> <p>Regulation (CAA) No. 05/2020 of 30 October 2020, implementing into the internal legal order of the Republic of Kosovo, Commission Regulation (EU) No. 2018/1139 of 4 July 2018 on common rules in the field of civil aviation and establishing a European Union Aviation</p>	<p>Generalni Direktor Autoriteta Civilnog Vaduhoplovstva Republike Kosova,</p> <p>U skladu sa članovima 3.5, 15.1 tačka (c), (e), i (j), 21.2 21.3 i 99.3, Zakona br. 03/L-051 o Civilnom Vazduhoplovstvu („Službeni list Republike Kosova“, Godina III , Br. 28, od 4 juna 2008), izmenjeno Zakonom br. 08/L-063 o izmeni i dopuni zakona koji se odnose na racionizaciju i uspostavljanje linija odgovornosti nezavisnih agencija („Službeni list Republike Kosova“, br. 2022/30, od 5 septembra 2022),</p> <p>Uzimajući u obzir,</p> <p>Međunarodne obaveze Republike Kosova prema Multilateralnom Sporazumu o Uspostavljanju Zajedničkog Evropskog Vazduhoplovnog Područja (u daljem tekstu "ECAA sporazum") od njegovog privremenog stupanja na snagu za Kosovo 10. oktobra 2006 godine,</p> <p>Uredbu (ACV) Br. 05/2020 od 30. octobra 2020. godine, kojom se u unutrašnji pravni poredak Republike Kosovo primenjuje Uredba Komisije (EU) Br. 2018/1139 od 4. jula 2018. godine, o zajedničkim pravilima u oblasti civilnog vazduhoplovstva i uspostavljanju</p>
---	---	---

<p>themelin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Sigurinë e Avacionit,</p>	<p>Safety Agency, ,</p>	<p>Evropske agencije za vazduhoplovnu bezbednost,</p>
<p>Regulloren (AAC) Nr. 09/2017 të datës 06 shtator 2017, e cila zbaton në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës Regulloren e Komisionit (EU) Nr. 376/2014 të datës 03 prill 2014, për raportimin, analizën dhe përcjelljen e ndodhive në avacionin civil, që ndryshon Rregulloren (EU) Nr. 996/2010 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe shfuqizon Direktivën 2003/42/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe Rregulloreve të Komisionit (EC) Nr. 1321/2007 dhe (EC) Nr. 1330/2007,</p>	<p>Regulation (CAA) No. 09/2017 of 06 September 2017, implementing into the internal legal order of the Republic of Kosovo, Commission Regulation (EU) No. 376/2014 of 03 April 2014 on the reporting, analysis and follow-up of occurrences in civil aviation, amending Regulation (EU) No 996/2010 of the European Parliament and of the Council and repealing Directive 2003/42/EC of the European Parliament and of the Council and Commission Regulations (EC) No 1321/2007 and (EC) No 1330/2007,</p>	<p>Uredbu (ACV) Br. 09/2017 od 06. septembra 2017. godine, kojom se u unutrašnji pravni poredak Republike Kosovo primenjuje Uredba Komisije (EU) Br. 376/2014 od 03. aprila 2014. godine o izveštavanju, analizi i naknadnom postupanju u vezi sa događajima u civilnom vazduhoplovstvu, o izmeni Uredbe (EU) br 996/2010 Evropskog parlamenta i Saveta i stavljanju van snage Direktive 2003/42/EZ Evropskog parlamenta i Saveta i Uredbi Komisije (EZ) br 1321/2007 i (EZ) br. 1330/2007,</p>
<p>Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara, në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesuara,</p>	<p>Upon completion of the process of public consultation of interested parties, in accordance with the Administrative Instruction No. 01/2012 on procedures for public consultation of interested parties,</p>	<p>Po završetku procesa javnih konsultacija zainteresovanih strana, u skladu sa Administrativnim uputstvom br. 01/2012 o procedurama za javne konsultacije o zainteresovanih strana,</p>
<p>Nxjerr këtë:</p>	<p>Hereby issues the following:</p>	<p>Izdaje sledeću:</p>
<p><b>Rregullore (AAC) nr. 07/2022 për plotësimin e Rregullores (AAC) NR. 09/2017 për raportimin, analizën dhe përcjelljen e ndodhive në avacionin civil, në lidhje me skemën e përbashkët evropiane të klasifikimit të rrezikut</b></p>	<p><b>Regulation (CAA) no. 07/2022 supplementing Regulation (CAA) NO 09/2017 on the reporting, analysis and follow-up of occurrences in civil aviation, as regards the common european risk classification scheme</b></p>	<p><b>Uredba (ACV) br. 07/2022 kojim se dopunjava Uredba (ACV) br. 09/2017 o izveštavanju, analizi i praćenju dogadaja u civilnom vazduhoplovstvu, u vezi sa zajedničkom evropskom šemom klasifikacije rizika</b></p>

<p><b>Neni 1 Qëllimi</b></p> <p>Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullorës së Deleguar të Komisionit (BE) 2020/2034 të 6 tetorit 2020 që plotëson Rregulloren (BE) nr. 376/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, lidhur me skemën e përbashkët evropiane të klasifikimit të rrezikut, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës.</p>	<p><b>Article 1 Purpose</b></p> <p>The purpose of this Regulation is the implementation of Commission Delegated Regulation (EU) 2020/2034 of 6 October 2020 supplementing Regulation (EU) No. 376/2014 of the European Parliament and of the Council as regards the common European risk classification scheme, into the internal legal order of the Republic of Kosovo.</p>	<p><b>Član 1 Cilj</b></p> <p>Cilj ove Uredbe je primena Komisije Delegirano Uredbu (EU) 2020/2034 od 6. oktobra 2020., koja dopune Uredbu (EU) br. 376/2014 Evropskog parlamenta i Saveta što se tiče zajedničke evropske šeme klasifikacije rizika, u unutrašnji pravni poredak Republike Kosovo.</p>
<p><b>Neni 2 Fushveprimi</b></p> <p>Kjo rregullore përcakton skemën e përbashkët Evropiane të klasifikimit të rrezikut (ERCS) për përcaktimin e rrezikut të sigurisë të një ndodhie.</p>	<p><b>Article 2 Subject Matter</b></p> <p>This Regulation sets out the common European risk classification scheme (ERCS) for the determination of the safety risk of an occurrence</p>	<p><b>Član 2 Subjekt materija</b></p> <p>Ova Uredba utvrđuje zajedničku evropsku šemu klasifikacije rizika (ERCS) za određivanje bezbednosnog rizika od događaja.</p>
<p><b>Neni 3 Definicionet</b></p> <p>Për qëllime të kësaj rregulloreje, do të zbatohen definicionet e mëposhtme:</p> <p>(1) ‘Skema evropiane e klasifikimit të rrezikut’ ose “ERCS” nënkupton metodologjinë e aplikuar për vlerësimin e rrezikut të paraqitur</p>	<p><b>Article 3 Definitions</b></p> <p>For the purposes of this Regulation, the following definitions shall apply:</p> <p>(1) ‘European risk classification scheme’ or ‘ERCS’ means the methodology applied for the assessment of the risk posed by an occurrence</p>	<p><b>Član 3 Definicije</b></p> <p>Za potrebe ove Uredbe, sledeće definicije će se primenjivati:</p> <p>(1) ‘Evropska šema klasifikacije rizika’ ili „ERCS“ označava metodologiju koja se primenjuje za procenu rizika koji predstavlja</p>

<p>nga një ndodhi në aviacionin civil në formën e një vlerësimi të rrezikut të sigurisë;</p> <p>(2) 'Matrica e ERCS-se' nënkupton një rrjet të përbërë nga variablat e përshkruar në Nenin 4(3) e cila shërben për paraqitjen ilustruese të vlerësimit(poentimit) të rrezikut të sigurisë;</p> <p>(3) 'vlerësimi i rrezikut të sigurisë" nënkupton rezultatin e klasifikimit të rrezikut të një dukurie duke kombinuar vlerat e variablate të përshkruar në Nenin 4(3);</p> <p>(4) 'zonë me rrezik të lartë' nënkupton një zonë ku një përplasje avioni do të shkaktonte lëndime të shumta, do të rezultonte në një numër të madh vdekjesh, ose të dyja për shkak të natyrës së aktiviteteve në atë zonë, të tilla si impiantet bërthamore ose kimike;</p> <p>(5) 'zonë e populuar' nënkupton një zonë me ndërtesa të grumbulluara ose të shpërndara dhe një popullsi të përhershme njerëzore, të tillë si qytet, vendbanim, qytetëz ose fshat;</p> <p>(6) 'lëndim që ndryshon jetën" nënkupton një dëmtim që ul cilësinë e jetës së personit në lidhje me lëvizshmërinë e reduktuar ose aftësinë e reduktuar njohëse ose fizike në jetën e përditshme.</p>	<p>to civil aviation in the form of a safety risk score;</p> <p>(2) 'ERCS matrix' means a grid made up of the variables described in Article 4(3) which serves for the illustrative representation of the safety risk score;</p> <p>(3) 'safety risk score' means the result of the risk classification of an occurrence by combining the values of the variables described in Article 4(3);</p> <p>(4) 'high-risk area' means an area where an aircraft impact would cause numerous injuries, result in a high number of fatalities, or both because of the nature of the activities in that area, such as nuclear or chemical plants;</p> <p>(5) 'populated area' means an area with clustered or scattered buildings and a permanent human population, such as city, settlement, town, or village;</p> <p>(6) 'life changing injury' means an injury reducing the person's quality of life in regard to reduced mobility or reduced cognitive or physical ability in daily life</p>	<p>događaj za civilno vazduhoplovstvo u obliku ocene (bodovanja) rizika za bezbednost;</p> <p>(2) 'ERCS matrica' označava mrežu sačinjenu od varijabli opisanih u Članu 4(3) koja služi za ilustrativno predstavljanje ocene (bodovanja) rizika bezbednosti;</p> <p>(3) 'ocena bezbednosnog rizika' znači rezultat klasifikacije rizika događaja kombinovanjem vrednosti varijabli opisanih u Članu 4(3);</p> <p>(4) 'područje visokog rizika' označava oblast u kojoj bi udar aviona prouzrokovao brojne povrede, rezultirao velikim brojem fatalnosti ili oboje zbog prirode aktivnosti u toj oblasti, kao što su nuklearna ili hemijska postrojenja;</p> <p>(5) 'naseljeno područje' označava područje sa grupisanim ili raštrkanim zgradama i stalnom ljudskom populacijom, kao što je grad, naselje, gradić ili selo;</p> <p>(6) 'povreda koja menja život' označava povredu koja umanjuje kvalitet života osobe u pogledu smanjene pokretljivosti ili smanjene kognitivne ili fizičke sposobnosti u svakodnevnom životu.</p>
---	--	--

<p><b>Neni 4</b>  <b>Skema e përbashkët Evropiane e klasifikimit të rrezikut</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. ERCS është përcaktuar në Shtojcë.</li> <li>2. ERCS do të trajtojë rrezikun e sigurisë të një ndodhje dhe jo rezultatin aktual të tij. Vlerësimi i çdo ndodhje do të përcaktojë rezultatin më të keq të mundshëm të aksidentit në të cilin mund të ketë çuar ndodhja, dhe sa afër rezultatit të aksidentit ishte ndodhja.</li> <li>3. ERCS do të bazohet në matricën e ERCS-së të përbërë nga dy variablat e mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) serioziteti: identifikimi i rezultatit më të keq të mundshëm të aksidentit që do të kishte rezultuar nëse ndodhja në vlerësim do të ishte përshkallëzuar në një aksident;</li> <li>(b) probabiliteti: identifikimi i mundësisë së ndodhisë në vlerësim të përshkallëzohet në rezultatin më të keq të aksidentit të përmendur në pikën (a).</li> </ul> </li> </ol>	<p><b>Article 4</b>  <b>Common European risk classification scheme</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. The ERCS is set out in the Annex.</li> <li>2. The ERCS shall address the safety risk of an occurrence and not its actual outcome. The assessment of each occurrence shall determine the worst likely accident outcome that the occurrence might have led to, and how close to that accident outcome the occurrence was.</li> <li>3. The ERCS shall be based on the ERCS matrix composed of the following two variables: <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) severity: identification of the worst likely accident outcome that would have resulted if the occurrence under assessment had escalated into an accident;</li> <li>(b) probability: identification of the likelihood of the occurrence under assessment to escalate into the worst likely accident outcome referred to in point (a).</li> </ul> </li> </ol>	<p><b>Član 4</b>  <b>Zajednička Evropska šema za klasifikaciju rizika</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. ERCS je data u Prilogu.</li> <li>2. ERCS është se baviti sigurnosnim rizikom od dogadaja, a ne njegovim stvarnim ishodom. Procena svakog dogadaja është odrediti najgori mogući ishod nesreće do kojeg je dogadaj mogao da dovede i koliko je blizak tom ishodu nesreće bio dogadaj.</li> <li>3. ERCS është se zasnivati na ERCS matrici sastavljenoj od sledeće dve varijable: <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) ozbiljnost: identifikacija najgoreg mogućeg ishoda nesreće do kojeg bi došlo da je dogadaj koji se procenjuje prerastao u nesreću;</li> <li>(b) verovatnoća: identifikacija verovatnoće da će dogadaj koji se procenjuje da eskalira u najgori ishod nesreće iz tačke (a).</li> </ul> </li> </ol>
--	---	--

<p><b>Neni 5</b> <b>Hyrja në fuqi</b></p> <p>Kjo rregullore hyn në fuqi më 01 janar 2023.</p> <p>Prishtinë, 30 shtator 2022</p> <hr/> <p><b>Bujar Ejupi</b> Drejtor i Përgjithshëm</p>	<p><b>Article 5</b> <b>Entry into force</b></p> <p>This Regulation shall enter into force from 1<sup>st</sup> January 2023.</p> <p>Prishtina, 30<sup>th</sup> September 2022.</p> <hr/> <p><b>Bujar Ejupi</b> Director General</p>	<p><b>Član 5</b> <b>Stupanje na snagu</b></p> <p>Ova Uredba stupa na snagu od 1. januara 2023.</p> <p>Priština, 30. septembar 2022.</p> <hr/> <p><b>Bujar Ejupi</b> Generalni Direktor</p>
--	--	--

## **SHTOJCA**

### **Skema e përbashkët Evropiane e klasifikimit të rrezikut**

ERCS do të përbëhet nga dy hapat e mëposhtëm:

HAPI 1: Përcaktimi i vlerave të dy variablate: serioziteti dhe probabiliteti.

HAPI 2: Vlerësimi (poentimi) i rrezikut të sigurisë brenda matricës së ERCS-së bazuar në dy vlerat e përcaktuara të variablate.

### **HAPI 1: PËRCAKTIMI I VLERAVE TË VARIABLAVE**

#### 1. Serioziteti i rezultatit të mundshëm të aksidentit

##### 1.1 Identifikimi

Identifikimi i seriozitetit të rezultatit të mundshëm të aksidentit do të ndjekë dy hapat e mëposhtëm:

- (a) përcaktimin e llojit më të mundshëm të aksidentit në të cilin ndodhia nën vlerësim mund të ishte përshkallëzuar (e ashtuquajtura zonë e rrezikut kyç);
- (b) përcaktimin e kategorisë së humbjes së mundshme të jetës bazuar në madhësinë e avionit dhe afërsinë me zonat e populluara ose me rrezik të lartë.

Ekzistojnë këto zonat kyçe të rrezikut:

- a. përplasje ajrore: një përplasje ndërmjet avionëve ndërsa të dy avionët janë në ajër; ose ndërmjet avionëve dhe objekteve të tjera ajrore (me përjashtim të shpendëve dhe kafshëve të egra);
- b. çregullim i aeroplanit: një gjendje e padëshiruar e aeroplanit e karakterizuar nga divergenca të paqëllimshme nga parametrat që zakonisht përjetohen gjatë operimeve, të cilat në fund mund të çojnë në një ndikim të pakontrolluar me terrenin;
- c. përplasje në pistë: një përplasje ndërmjet aeroplanit dhe një objekti tjetër (aeroplanë të tjera, automjete, etj.) ose personit që ndodh në një pistë aerodromi ose në një zonë tjetër uljeje të paracaktuar. Nuk përfshin përplasjet me zogjtë ose kafshë të egra;
- d. ekskursion: një ndodhi kur një aeroplan largohet nga pista ose zona e lëvizjes së aerodromit ose sipërfaqja e uljes së çdo zone tjetër uljeje të paracaktuar, pa u futur në ajër. Kjo përfshin uljet vertikale me ndikim të lartë për aeroplanë me krahë rrotullues ose ngritje dhe ulje vertikale të aeroplanëve dhe balonave ose anijeve ajrore;
- e. zjarri, tymi dhe aplikimi i presionit: një ndodhi që përfshin raste zjarri, tymi, avujt mbytës ose situata nën aplikim presioni që mund të bëhen të papajtueshme me jetën e njeriut. Kjo përfshin ndodhitë që përfshijnë zjarrin, tymin ose avujt mbytës që prekin çdo pjesë të një aeroplani, në fluturim ose në tokë, e cila nuk është rezultat i ndikimit ose veprimeve keqdashëse;
- f. dëmtimi në tokë: dëmtimi i aeroplanit i shkaktuar nga operimi i aeroplanit në tokë në çdo zonë

tjetër tokësore përvëç pistës ose zonës së paracaktuar të uljes, si dhe dëmtimi gjatë mirëmbajtjes;

- g. përplasje me pengesa në fluturim: përplasje ndërmjet një aeroplani në ajër dhe pengesave që dalin nga sipërfaqja e tokës. Pengesat përfshijnë ndërtesat e larta, pemët, kabllot e energjisë, telat dhe antenat telegrafike si dhe objektet e lidhura;
- h. përplasje terreni: një ndodhi ku një aeroplan në ajër përplaset me terrenin, pa indikacion se ekuipazhi i fluturimit nuk ishte në gjendje të kontrollonte avionin. Kjo përfshin rastet kur ekuipazhi i fluturimit ndikohet nga iluzione vizuale ose mjedisi vizual i degraduar;
- i. lëndime të tjera: një dukuri ku janë shkaktuar lëndime vdekjeprurëse ose jo vdekjeprurëse, të cilat nuk mund t'i atribuohen ndonjë zone tjetër të rrezikshme;
- j. sigurimi: një akt i ndërhyrjes së paligjshme kundër aviacionit civil. Përfshin të gjitha incidentet dhe shkeljet që lidhen me survejimin (vëzhgim) dhe mbrojtjen, kontrollin e hyrjes (qasjes), verifikimin, zbatimin e kontrolleve të sigurisë dhe çdo akt tjetër që synon të shkaktojë shkatërrim me qëllim të keq ose të paarsyeshëm të aeroplanit dhe pronës, duke rrezikuar ose rezultuar në ndërhyrje të paligjshme në aviacionin civil dhe objektet e tij. Përfshin të dyja, ngjarjet e sigurisë fizike dhe kibernetike.

Humbja e mundshme e jetës do të kategorizohet në këtë mënyrë:

- (a) më shumë se 100 fatalitete të mundshme – ku ndodhia në vlerësim përfshin të paktën njërin nga këto:
  - një aeroplan i madh i certifikuar me më shumë se 100 pasagjerë të mundshëm në bord;
  - një aeroplan me madhësi ekivalente për ngarkesë;
  - një aeroplan i çdo lloji në një zonë shumë të populuar ose në një zonë me rrezik të lartë ose të dyja;
  - çdo situatë që përfshin çdo lloj aeroplani ku mund të jenë të mundshme më shumë se 100 fatalitete;
- (b) nga 20 deri në 100 fatalitete të mundshme – ku ndodhia në vlerësim përfshin të paktën njërin nga këto:
  - një avion mesatar i certifikuar me 20 deri në 100 pasagjerë të mundshëm në bord ose madhësi ekivalente për aeroplanët e ngarkesave;
  - çdo situatë ku mund të jenë të mundshme 20 deri në 100 fatalitete;
- (c) ndërmjet 2 deri në 19 fatalitete të mundshme kur ndodhia në vlerësim përfshin të paktën njërin nga këto:
  - një aeroplan i vogël i certifikuar me deri në 19 pasagjerë të mundshëm në bord;
  - një madhësi ekivalente për aeroplanët e ngarkesave;

- çdo situatë ku mund të jenë të mundshme 2 deri në 19 fatalitete;

(d) 1 fatalitet i mundshëm – kur ndodhia në vlerësim përfshin të paktën njërën nga këto:

- një aeroplan i pa certifikuar, që është aeroplan që nuk i nënshtrohet kërkeseave të certifikimit të Agjencisë Evropiane të Sigurisë së Avacionit;
- çdo situatë ku mund të jetë e mundur një fatalitet i vetëm;

(e) 0 fatalitete të mundshme – ku ndodhia në vlerësim përfshin vetëm lëndime personale, pavarësisht nga numri i lëndimeve të lehta dhe të rënda për sa kohë që nuk ka fatalitete.

## 1.2. Përcaktimi

Serioziteti i aksidentit do të rezultojë në një nga pikët e mëposhtme të seriozitetit:

- ‘A’ e cila qëndron për atë kur nuk ka gjasa për një aksident;
- ‘E’ e cila qëndron për një aksident që përfshin lëndime të vogla dhe serioze (që nuk ndryshojnë jetën) ose dëmtime të vogla të aeroplanit;
- ‘I’ e cila qëndron për një aksident që përfshin një fatalitet të vetëm, lëndim që ndryshon jetën ose aksident me dëme të konsiderueshme;
- ‘M’ e cila qëndron për një aksident të madh me sasi të kufizuar fatalitetesh, lëndime që ndryshojnë jetën ose shkatërrimin e aeroplanit;
- ‘S’ e cila qëndron për një aksident të rëndësishëm me potencial për fatalitete dhe lëndime;
- ‘X’ e cila qëndron për një aksident ekstrem katastrofal me potencial për një numër të konsiderueshëm fatalitetesh.

Pika e seriozitetit do të llogaritet duke kombinuar zonën kyçë të rrezikut dhe humbjen e mundshme të jetës, siç përcaktohet në tabelën e mëposhtme:

FUSA KYÇË E RREZIKUT	KATEGORIA	PIKA E SERIOZITETIT
Përplasje ajrore	Më shumë se 100 fatalitete të mundshme	X
	Ndërmjet 20 deri në 100 fatalitete të mundshme	S
	Ndërmjet 2 deri në 19 fatalitete të mundshme	M
	1 fatalitet i mundshëm	I
Çrrregullimi aeroplanit	Më shumë se 100 fatalitete të mundshme	X
	Ndërmjet 20 deri në 100 fatalitete të mundshme	S
	Ndërmjet 2 deri në 19 fatalitete të mundshme	M
	1 fatalitet i mundshëm	I
Përplasje në pistë	Më shumë se 100 fatalitete të mundshme	X
	Ndërmjet 20 deri në 100 fatalitete të mundshme	S

	Ndërmjet 2 deri në 19 fatalitete të mundshme	M
	1 fatalitet i mundshëm	I
	0 fatalitete të mundshme	E
Rrëshqitjet	Ndërmjet 20 deri në 100 fatalitete të mundshme	S
	Ndërmjet 2 deri në 19 fatalitete të mundshme	M
	1 fatalitet i mundshëm	I
	0 fatalitete të mundshme	E
Zjarri, tymi dhe aplikimi i presionit	Më shumë se 100 fatalitete të mundshme	X
	Ndërmjet 20 deri në 100 fatalitete të mundshme	S
	Ndërmjet 2 deri në 19 fatalitete të mundshme	M
	1 fatalitet i mundshëm	I
Dëmtimi në tokë	Ndërmjet 2 deri në 19 fatalitete të mundshme	M
	1 fatalitet i mundshëm	I
	0 fatalitete të mundshme	E
Përplasja në fluturim	Më shumë se 100 fatalitete të mundshme	X
	Ndërmjet 20 deri në 100 fatalitete të mundshme	S
	Ndërmjet 2 deri në 19 fatalitete të mundshme	M
	1 fatalitet i mundshëm	I
Përplasje në terren	Më shumë se 100 fatalitete të mundshme	X
	Ndërmjet 20 deri në 100 fatalitete të mundshme	S
	Ndërmjet 2 deri në 19 fatalitete të mundshme	M
	1 fatalitet i mundshëm	I
Lëndime të tjera	Ndërmjet 20 deri në 100 fatalitete të mundshme	S
	Ndërmjet 2 deri në 19 fatalitete të mundshme	M
	1 fatalitet i mundshëm	I
	0 fatalitete të mundshme	E
Sigurimi	Më shumë se 100 fatalitete të mundshme	X
	Ndërmjet 20 deri në 100 fatalitete të mundshme	S
	Ndërmjet 2 deri në 19 fatalitete të mundshme	M
	1 fatalitet i mundshëm	I
	0 fatalitete të mundshme	E

## 2. Probabiliteti i rezultatit të mundshëm të aksidentit

Probabiliteti i rezultatit më të keq të mundshëm të aksidentit do të merret duke përdorur modelin i barrierës ERCS të përcaktuar në Seksionin 2.1.

### 2.1. Modeli i barrierës ERCS

Qëllimi i modelit të barrierës ERCS është të vlerësojë efektivitetin (që është numri dhe forca) e

barrierave në sistemin e sigurisë të përcaktuara në tabelën në Seksionin 2.1.1, të cilat mbetën midis ndodhjes aktuale dhe rezultatit më të keq të mundshëm të aksidentit. Përfundimisht, modeli i barrierës ERCS do të përcaktojë se sa afër ka qenë ndodhja në vlerësim me aksidentin e mundshëm.

### 2.1.1. Barrierat

Modeli i barrierës ERCS përbëhet nga 8 barriera, të renditura në një sekuencë logjike dhe të peshuara sipas tabelës së mëposhtme:

Numri i barrierës	Barriera	Pesha e barrierës
1	'Projektimi i aeroplanëve, pajisjeve dhe infrastrukturës', përfshin mirëmbajtjen dhe korrigimin, mbështetjen e funksionimit, parandalimin e problemeve që lidhen me faktorët teknikë që mund të çojnë në një aksident.	5
2	'Planifikimi taktik', përfshin planifikimin organizativ dhe individual përparrë fluturimit ose një aktivitet tjeter operacional që mbështet reduktimin e shkaqeve dhe kontribuuesve në aksidente.	2
3	'Rregulloret, procedurat, proceset', përfshin rregulloret, procedurat dhe proceset efektive, të kuptueshme dhe të disponueshme të cilat respektohen (me përashtim të përdorimit të procedurave për barrierat e rikuperimit).	3
4	'Ndërgjegjësimi për situatën dhe veprimi', përfshin vigilencën njerëzore përkërcënimet operacionale që siguron identifikimin e rreziqeve operacionale dhe veprimin efektiv për të parandaluar një aksident.	2
5	'Funksionimi dhe veprimi i sistemeve të paralajmërimi' që mund të parandalojnë një aksident dhe që janë të përshtatshme për qëllimin, funksionimin, operacionale dhe respektohen.	3
6	'Rimëkëmbja e vonë nga një situatë e mundshme aksidenti'	1
7	'Mbrojtjet', kur një ngjarje ka ndodhur, niveli i rezultatit zbutet ose parandon përshkallëzimin e ndodhisë nga barrierat ose parashikimet e paprekshme	1
8	'Ndodhi me energji të ulët' vlerësohet njësoj si "Mbrojtjet", por vetëm për zonat me rrezik kyç me energji të ulët (dëmtime në tokë, ekskursione, lëndime). 'Nuk zbatohet' për të gjitha fushat e tjera kyçë të rrezikut.'	1

### 2.1.2. Efektiviteti i barrierës

Efektiviteti i secilës barrierë do të klasifikohet si më poshtë:

- '**e Ndaluar**' nëse barriera ka parandaluar aksidentin që të ndodhte;
- '**Mbetet e njojur**': nëse dihet nëse ka mbetur barriera midis ndodhisë në vlerësim dhe rezultatit të mundshëm të aksidentit;
- '**Mbetet e supozuar**': nëse supozohet se barriera ka mbetur midis ndodhisë në vlerësim dhe rezultatit të mundshëm të aksidentit;
- '**E njojur e dështuar**': nëse dihet se barriera ka dështuar;

- '**Supozohet e dështuar**': nëse supozohet se barriera ka dështuar edhe nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm ose nuk ka informacion për të përcaktuar këtë;
- '**Nuk zbatohet**': nëse barriera nuk është e rëndësishme për ndodhinë në vlerësim.

### 2.1.3. Vlerësimi i barrierave

Barrierat do të vlerësohen në dy hapa:

Hapi 1: Për të identifikuar se cila nga barrierat e përcaktuara në tabelën në seksionin 2.1.1. (1-8) ndaloj që dukuria të përshkallëzohej në rezultatin e mundshëm të aksidentit (e referuar si 'barriera e ndalimit').

Hapi 2: Për të identifikuar në përputhje me seksionin 2.1.2 efektivitetin e barrierave të mbetur. Barrierat e mbetur janë ato barriera të renditura në tabelën në seksionin 2.1.1 të cilat vendosen midis barrierës së ndalimit dhe rezultatit të mundshëm të aksidentit. Barrierat e renditura në tabelën në seksionin 2.1.1 të cilat janë vendosur përparrë barrierës së ndalimit nuk do të konsiderohen se kanë kontribuar në parandalimin e rezultatit të aksidentit dhe përrnjedhojë ato barriera nuk do të vlerësohen si 'të Ndalura' ose 'të Mbetura'.

## 2.2. Llogaritja

Probabiliteti i rezultatit të mundshëm të aksidentit është vlera numerike që rezulton nga hapat e mëposhtëm:

Hapi 1: Shuma e të gjitha peshave të barrierave (1 deri në 5) të paraqitura në tabelën në seksionin 2.1.1 të të gjitha barrierave të vlerësuara që u vlerësuan ose "të Ndalura", "të mbetur të njohura" ose "të mbetur të supozuara". Barrierat 'e Dështuara' dhe 'të Pazbatueshme' nuk do të llogariten për rezultatin (pikë) përfundimtar, pasi ato barriera nuk mund të kishin parandaluar aksidentin. Shuma e peshës së barrierës që rezulton është një vlerë numerike midis 0 dhe 18.

Hapi 2: Shuma e peshës së barrierës korrespondon me pikë të pengesës midis 0 dhe 9 sipas tabelës së mëposhtme, duke mbuluar gamën e plotë midis pengesave të mbeturës të forta dhe të dobëta.

Shuma e peshës së barrierave	Pikët që korrespondojnë me barrierën
0 Nuk ka mbetur asnjë barrierë. Rezultati më i keq i mundshëm i aksidentit është realizuar.	0
1-2	1
3-4	2
5-6	3
7-8	4
9-10	5
11-12	6
13-14	7

15-16	8
17-18	9

## HAPI 2: VLERËSIMI ME PIKË I RREZIKUT SIGURISË BRENDË MATRICËS ERCS

Vlerësimi me pikë i rrezikut të sigurisë është një vlerë dyshifrore ku shifra e parë korrespondon me vlerën alfabetike që rezulton nga llogaritja e seriozitetit të ndodhjes (Vlerësimi me pikë i seriozitetit nga A deri në X) dhe shifra e dytë përfaqëson vlerën numerike nga llogaritja e vlerësimit korrespondues me pikë të ndodhjes (0 deri në 9).

Vlerësimi me pikë i rrezikut të sigurisë do të vendoset në matricën ERCS.

Për secilin vlerësim me pikë të dhënë të rrezikut të sigurisë, ekziston gjithashtu një vlerësimi ekuivalent numerik me pikë për qëllime të grumbullimit dhe analizës, i cili shpjegohet më poshtë nën ‘Vlerësimi me pikë ekuivalent numerik’.

Matrica ERCS pasqyron vlerësimin me pikë të rrezikut të sigurisë dhe shifrat numerike të lidhura të një ndodhje si më poshtë:

ASHPËRSIA		KLASIFIKIMI (Shkalla ERCS)										
Rezultat i Mundshëm i Aksidentit	Shkalla											
Aksident ekstrem katastrofik me potencial për një numër të konsiderueshëm viktimash (100+)	X	Në përtje të vlerësimit të rrezikut	X9	X8	X7	X6	X5	X4	X3	X2	X1	X0
Aksident i rëndë me potencial për vdekje dhe lëndime (20 - 100)	S		S9	S8	S7	S6	S5	S4	S3	S2	S1	S0
Aksident madhor me numër të kufizuar të viktimave (2-19), lëndime që ndryshojnë jetën ose shkatërrim i avionit	M		M9	M8	M7	M6	M5	M4	M3	M2	M1	M0
Një aksident që përfshin fatalitet të vetëm individual, lëndime që ndryshojnë jetën ose dëmtimë të konsiderueshme të avionit	I		I9	I8	I7	I6	I5	I4	I3	I2	I1	I0
Një aksident që përfshin një lëndim të vetëm të vogël dhe të rëndë (që nuk ndryshon jetën) ose dëmtimë të vogla të avionit	E		E9	E8	E7	E6	E5	E4	E3	E2	E1	E0
Asnjë gjasë për një aksident	A		Asnjë Implikim për Sigurinë									
	Rezultati Përkatës i Barrierës	9	8	7	6	5	4	3	2	1		0
	Shuma e Peshës së Barrierës	17-18	15-16	13-14	11-12	9-10	7-8	5-6	3-4	1-2		0
PROBABILITETI I REZULTATIT TË MUNDSHËM TË AKSIDENTIT												

Përveç vlerësimit me pikë të rrezikut të sigurisë dhe për të lehtësuar përcaktimin e urgjencës së veprimit të rekomanduar që duhet të ndërmerret në lidhje me ndodhinë, tre ngjyrat e mëposhtme mund të përdoren në matricën ERCS:

Ngjyra	Vlerësimi me pikë i ERCS-së	Kuptimi
E KUQE	X0, X1, X2, S0, S1, S2, M0, M1, I0	Rreziku i lartë. Ndodhitë me rrezikshmërinë më të lartë.
E VERDHE	X3, X4, S3, S4, M2, M3, I1, I2, E0, E1	Rreziku i ngritur. Ndodhitë me rrezik të ndërmjetëm
E GJELBËR	X5 deri X9, S5 deri S9, M4 deri M9, I3 deri I9, E2 deri E9.	Ndodhitë me rrezik të ulët

Zona e gjelbër e matricës përban vlera më të ulëta rreziku. Ato ofrojnë të dhëna për analiza të thella mbi ndodhitë që lidhen me sigurinë, të cilat mund të rrisin vlerat e rrezikut të ndodhive të tillë, si të izoluara ose të ndërlidhura me ngjarje të tjera.

### Vlerësimi me pikë ekuivalent numerik

Çdo vlerësimi me pikë të ERCS-së i caktohet një vlerë numerike korresponduese e madhësisë së rrezikut për të lehtësuar grumbullimin dhe analizën numerike të ndodhive të shumëfishta me një vlerësim pikë të ERCS-së:

Vlerësimi me pikë i ERCS-së	X9	X8	X7	X6	X5	X4		X3	X2	X1	X0
Vlera korresponduese numerike	0,001	0,01	0,1	1	10	100		1000	10000	100000	1000000
Vlerësimi me pikë i ERCS-së	S9	S8	S7	S6	S5	S4		S3	S2	S1	S0
Vlera korresponduese numerike	0,0005	0,005	0,05	0,5	5	50		500	5000	50000	500000
Vlerësimi me pikë i ERCS-së	M9	M8	M7	M6	M5	M4		M3	M2	M1	M0
Vlera korresponduese numerike	0,0001	0,001	0,01	0,1	1	10		100	1000	10000	100000
Vlerësimi me pikë i ERCS-së	I9	I8	I7	I6	I5	I4		I3	I2	I1	I0
Vlera korresponduese numerike	0,00001	0,0001	0,001	0,01	0,1	1		10	100	1000	10000
Vlerësimi me pikë i ERCS-së	E9	E8	E7	E6	E5	E4		E3	E2	E1	E0
Vlera korresponduese numerike	0,000001	0,00001	0,0001	0,001	0,01	0,1		1	10	100	1000

Si kolona 10 ashtu edhe rreshti A në matricë mbajnë vlerën 0 si vlerë korresponduese numerike.

## ANNEX

### **The common European risk classification scheme**

The ERCS shall consist of the following two steps:

STEP 1: Determination of the values of the two variables: severity and probability.

STEP 2: Scoring of the safety risk within the ERCS matrix based on the two determined values of variables.

#### **STEP 1: DETERMINATION OF THE VALUES OF THE VARIABLES**

1. Severity of the potential accident outcome

1.1. Identification

The identification of the severity of the potential accident outcome shall follow the following two steps:

- a) a determination of the most likely type of accident that the occurrence under assessment could have escalated to (the so called key risk area);
- b) a determination of the potential loss of life category based on aircraft size and proximity to populated or high-risk areas.

There are following key risk areas:

